



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 237/1 Prot.

Gjirokastër, më 25.02.2021.

Lënda: Përcillet vendimi Nr.8, datë . 25.02. 2021 i Bordit të Administrimit.

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", PROF. DR. BEKTASH MEMA

ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", Z. SEMI GOLEMI

KËTU

KRYETAR

Dr. Merita ISARAJ



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 237 Prot.

Gjirokastër, më 25.02.2021

V E N D I M

NR. 8 , datë 25.02.2021

**MIRATIMI I LISTËS SË STUDENTËVE PRETENDENTUES PËR TË PËRFITUAR
BURSË DHE PËR TU PËRJASHTUAR NGA PAGESA E TARIFËS SË SHKOLLIMIT**

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë" neni 49., VKM-së 784 datë 26.12.2018; VKM-së Nr.,39 datë 23.01.2019; VKM-së Nr., 40 datë 23.01.2019, VKM-së 780, datë 26.12.2018, si dhe në shkresën e Administratorit me nr. 226 prot., datë 23.02.2021, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 25.02.2021,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listat e studentëve pretendues për t`u trajtuar me bursë;
2. Të miratojë listën e studentëve të ciklit të parë të studimeve; program të integruar ose studime profesionale që përjashtohen nga pagesa e tarifës së shkollimit në masën 100%;
3. Të miratojë listën e studentëve të ciklit të dytë të studimeve që përjashtohen nga pagesa e tarifës së shkollimit në masën 50%;
4. Bashkangjitur vendimit gjendet lista e studentëve të kategorive më sipër;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;

